


IQOS


Udhëzuesi i përdorimit

IQOS ORIGINALS DUO™

Karikuesi i xhepit IQOS ORIGINALS DUO™*




Mbajtësi IQOS ORIGINALS DUO™*




*IQOS ORIGINALS DUO™ është i pajtueshëm me IQOS 3 dhe IQOS 3 DUO.

*Përdorni vetëm IQOS ORIGINALS DUO me HEETS™ të krijuar posaçërisht për IQOS ORIGINALS DUO.

Karikimi dhe pastrimi



Kabloja e karikimit



Përshtatësi i energjisë



Pajisja pastruese
e dyfishtë



Shkopinjë
e pastrimit



Për udhëzuesin e plotë të përdorimit, Kujdesin e Klientit dhe Shërbimet e zgjeruara të asistencës për përdoruesit e IQOS, vizitoni

www.iqos.com/myiqos


FUNKSIONET DHE CILËSIMET

Personalizoni përvojën tuaj me IQOS me aplikacionin IQOS*.

Hyni duke skanuar kodin QR ose lidhuni në www.iqos.com/originals dhe ndiqni udhëzimet.


* Aplikacioni IQOS mund të mos jetë i disponueshëm në vendin tuaj.

Fillimi



NDIZENI

Shtypni dhe mbani shtypur butonin e karikuesit të xhepit IQOS ORIGINALS DUO™ për 4 sekonda, më pas lëshojeni; Dritat e statusit të mbajtësit dhe dritat e statusit të karikuesit të xhepit do të ndizen ngadalë.



KARIKONI MBAJTËSIN

Futni mbajtësin IQOS ORIGINALS DUO™ në karikuesin e xhepit IQOS ORIGINALS DUO™, më pas mbyllni kapakun për ta karikuar. Drita e statusit të mbajtësit do të tregojë nivelin e karikimit të tij.


Kontrolloni statusin e mbajtësit



KONTROLLONI STATUSIN E MBAJTËSIT

Shtypni dhe lëshoni butonin e mbajtësit për të kontrolluar statusin.


Dritat e mbajtësit tregojnë nivelin e baterisë së mbajtësit IQOS ORIGINALS DUO™.



KONTROLLONI STATUSIN E MBAJTËSIT NË KARIKUESIN E XHEPIT IQOS ORIGINALS DUO™


Shtypni dhe lëshoni butonin e karikuesit të xhepit për të kontrolluar nivelin e baterisë së mbajtësit IQOS ORIGINALS DUO™.

Si ta përdorni IQOS ORIGINALS DUO™



1. VENDOSNI FIJET E DUHANIT ME NGROHJE


Vendosni dhe shtypni lehtësisht fijen e duhanit me ngrohje deri në vijën e filtrit, me filtrin me drejtim nga jashtë.



2. FILLONI NGROHJEN

Shtypni butonin e mbajtësit derisa mbajtësi IQOS ORIGINALS DUO™ të dridhet dhe drita të pulsojë.

Si ta përdorni IQOS ORIGINALS DUO™




3. FILLONI PËRDORIMIN

Filloni ta përdorni kur mbajtësi IQOS ORIGINALS DUO™ të dridhet dy herë.



4. POTHUAJSE KA PËRFUNDUAR



Për të sinjalizuar 30 sekondat ose 2 thithjet e fundit, mbajtësi IQOS ORIGINALS DUO™ do të dridhet dy herë dhe drita do të pulsojë e bardhë.



5. HIQNI FIJET E DUHANIT ME NGROHJE

Rrëshqitni kapakun lart e më pas hiqni fijet e përdorura të duhanit me ngrohje.

Si ta pastroni



1. PJESA RROTULLUESE


Kur pajisja është e ftohtë, rrëshqiteni kapakun lart dhe hiqeni atë plotësisht.

Futni pjesën rrotulluese të pajisjes pastruese të dyfishtë dhe **rrotullojeni** ngadalë.

2. PJESA FSHIRËSE

Futni pjesën fshirëse të pajisjes pastruese të dyfishtë dhe lëvizeni atë me kujdes anash nga **e majta në të djathtë.**


Pastrojeni çdo ditë për një përvojë optimale.



PËRDORNI SHKOPIN E PASTRIMIT

Përdorni shkopin e pastrimit për ta fshirë mbajtësin nga brenda. Mos e prekni teahun ngrohës me shkopin e pastrimit.


Këshilla të shpejta



KONTROLLONI STATUSIN E KARIKUESIT TË XHEPIT

Shtypni dhe lëshoni butonin e karikuesit të xhepit për të kontrolluar nivelin e baterisë.


Dritat do të ndizen për të treguar statusin e baterisë.



PËR TA RIVENDOSUR


Shtypni butonin e karikuesit të xhepit derisa drita të zbehet, më pas lëshojeni.

Të gjitha dritat e statusit do të fiken, do të pulsojnë dy herë dhe do të zbehen gradualisht, për të konfirmuar një RIVENDOSJE.



DRITAT PULSOJNË TË BARDHA DY HERË

IQOS operon në temperaturën e jashtme (0° C - 40° C) ose mbajtësi duhet të vendoset në karikuesin e xhepit me kapakun të mbyllur, derisa të karikohet plotësisht.



DRITA PULSON E KUQE

Rivendosni IQOS ORIGINALS DUO™. Nëse drita e kuqe vazhdon të pulsojë, kontaktoni Kujdesin e Klientit.

IQOS



Ky është simboli i alarmit të sigurisë.
Përdoret për t'ju njoftuar se ka rreziqe
të mundshme lëndimesh fizike.

PARALAJMËRIME DHE UDHËZIME PËR SIGURINË

JU LUTEMI T'I LEXONI TË GJITHA PARALAJMËRIMET DHE UDHËZIMET E SIGURISË PËRPARA PËRDORIMIT, PËR TË SHMANGUR LËNDIMET.

Këto paralajmërime dhe udhëzime të sigurisë nuk mund t'i mbulojnë të gjitha situatat e mundshme që mund të ndodhin, ndaj përdoruesit duhet të jenë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm.

RUAJINI KËTO PARALAJMËRIME DHE UDHËZIME TË SIGURISË PËR T'IU REFERUAR NË TË ARDHMEN, PASI PËRMBAJNË INFORMACIONE TË RËNDËSISHME.

Përdoruesit e synuar

- *IQOS ORIGINALS DUO™ dhe fijet e duhanit janë vetëm për të rritur.*
- *IQOS ORIGINALS DUO™ dhe fijet e duhanit janë krijuar për t'u përdorur nga duhanpirësit e rritur, të cilët do të vazhdonin përndryshe të pinin duhanin e zakonshëm.*
- *Fëmijët dhe adoleshentët nuk duhet të përdorin IQOS ORIGINALS DUO™ apo fijet e duhanit asnjëherë dhe në asnjë rrethanë.*
- *IQOS ORIGINALS DUO™ ose fijet e duhanit nuk duhet të përdoren nga njerëz me aftësi të reduktuara fizike, shqisore ose mendore, apo mungesë përvoje dhe njohurie, përveçse nëse janë të mbikëqyrur ose janë udhëzuar në lidhje me përdorimin e tyre dhe i kuptojnë rreziqet e përfshira.*

Duhani dhe nikotina

- *Fijet e duhanit përmbajnë nikotinë, e cila krijon varësi.*
- *IQOS ORIGINALS DUO™ dhe fijet e duhanit nuk janë pa rrezik. Mënyra më e mirë për të reduktuar rreziqet shëndetësore të lidhura me duhanin është lënia plotësisht e përdorimit të tij dhe nikotinës.*
- *Disa përdorues të IQOS ORIGINALS DUO™ dhe fijeve të duhanit kanë raportuar se kanë pasur dhimbje barku, dhimbje gjoksi, ndjesi të mbytjes, kollë, vështirësi në frymëmarrje, marrje mendsh, gojë të thatë, grykë të thatë, probleme me mishrat e dhëmbëve, dhimbje koke, parehati, bllokim hundësh, të përziera, acarim të gojës, takikardi, acarim të fytit dhe të vjella.*
- *Produktet që përmbajnë nikotinë nuk duhet të përdoren nga njerëz që vuajnë ose rrezikojnë të preken nga sëmundje të zemrës, janë diabetikë, epileptikë ose kanë kriza.*

- Produktet që përmbajnë nikotinë nuk duhet të përdoren gjatë shtatzënisë ose gjatë ushqyerjes me gji. Nëse jeni shtatzënë, ushqeni me gji ose dyshoni se jeni shtatzënë, duhet të hiqni dorë fare nga përdorimi i duhanit dhe nikotinës.
- Lënia e duhanit ose kalimi te IQOS ORIGINALS DUO™ dhe fijet e duhanit ose produktet e tjera që përmbajnë nikotinë mund të kërkojë rregullimin e dozës së disa ilaçeve (p.sh. teofilina, klozapina, ropiniroli).
- Në rast se nuk jeni të sigurt nëse mund të përdorni IQOS ORIGINALS DUO™ dhe fijet e duhanit si pasojë e një problemi ekzistues shëndetësor, këshillohuni me një profesionist të kujdesit shëndetësor.

⚠ INFORMACIONE TË RËNDËSISHME PËR SIGURINË

⚠ PARALAJMËRIM Rreziku i mbytjes dhe gëlltimit

- Mbjajeni IQOS ORIGINALS DUO™ dhe fijet e duhanit larg nga fëmijët dhe kafshët shtëpiake.
- RREZIK MBYTJEJE — aksesorët e IQOS ORIGINALS DUO™ dhe fijet e duhanit përmbajnë pjesë të imëta.
- RREZIK GËLLTITJEJE — Nëse fijet e duhanit gëlltiten, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore për shkak të rrezikut të helmimit nga nikotina.


⚠ PARALAJMËRIM Rreziqet nga pjesët elektronike dhe bateria

Rreziqet elektrike

Mosrespektimi i këtyre paralajmërimeve dhe udhëzimeve të sigurisë mund të shkaktojë zjarr, shpërthim, goditje elektrike, lëndim ose dëmtim të produktit apo pronave të tjera:

- IQOS ORIGINALS DUO™ duhet të përdoret vetëm nga përdoruesit e synuar.
- Karikuesin e xhepit IQOS ORIGINALS DUO™ karikojeni vetëm me modelin e miratuar të përshtatësit IQOS ORIGINALS DUO™ të ofruar në kuti ose të disponueshëm në dyqanet lokale apo ato në internet, posaçërisht për qëllime karikimi. Shikoni seksionin e të dhënave teknike të këtij udhëzuesi përdorimi, për listën e modeleve të miratuara të përshtatësit IQOS ORIGINALS DUO™.
- Mos përdorni pajisje të palëve të treta me IQOS ORIGINALS DUO™.
- Karikojeni karikuesin e xhepit IQOS ORIGINALS DUO™ vetëm duke përdorur një tension sigurie shumë të ulët.

Shikoni seksionin e të dhënave teknike të këtij udhëzuesi përdorimi, për detaje në lidhje me tensionin.

- . Mos e përdorni IQOS ORIGINALS DUO™ në vendet ku ndalohet përdorimi i pajisjeve elektronike.
- . Karikojeni karikuesin e xhepit IQOS ORIGINALS DUO™ brenda në shtëpi, siç tregohet nga simboli .
- . Mos e përdorni IQOS ORIGINALS DUO™ ose mos e karikoni karikuesin e xhepit IQOS ORIGINALS DUO™ dhe/ose aksesorët IQOS ORIGINALS DUO™ nëse ato dëmtohen, modifikohen apo prishen.
- . Mos e përdorni IQOS ORIGINALS DUO™ nëse bateritë e tij duket sikur po rrjedhin.
- . Mos përdorni, karikoni ose vendosni IQOS ORIGINALS DUO™ në vende me temperaturë të lartë (si brenda një makine gjatë verës, ose pranë burimeve të nxehtësisë, siç janë radiatorët ose oxhakët).
- . Mos e përdorni IQOS ORIGINALS DUO™ kur ka të pranishme materiale, lëngje dhe gaze që marrin flakë.
- . Mos e zhytni ose vendosni asnjëherë IQOS ORIGINALS DUO™ ose aksesorët e tij në kontakt me ujin dhe/ose lëngje të tjera. Mos e prekni IQOS ORIGINALS DUO™ dhe/ose aksesorët e tij nëse ato lagen ose zhyten në ndonjë lëng.
- . Mos e asgjësoni asnjëherë IQOS ORIGINALS DUO™ dhe/ose aksesorët e tij me mbeturina të tjera shtëpiake, pasi mund të bien në kontakt me ujin dhe/ose lëngje të tjera.
- . Mos e pastroni pajisjen me agjent pastrues.

- Pastroni periodikisht portën USB të karikimit në karikuesin e xhepit IQOS ORIGINALS DUO™ për të shmangur grumbullimin e materialeve të huaja (si grimcat e pluhurit) dhe kontrolloni portën USB nëse ka materiale të huaja, përpara se të përdorni kablirin USB.
- Shkëputni IQOS ORIGINALS DUO™ dhe/ose aksesoret e tij nga çdo burim i energjisë nëse tejnë, lëshojnë tym, ndizen ose digjen gjatë karikimit.
- Mos e prekni IQOS ORIGINALS DUO™ dhe/ose aksesoret e tij nëse ato tejnë, lëshojnë tym, ndizen ose digjen.
- Trajtojini me kujdes. Kujdesuni që IQOS ORIGINALS DUO™ të mos bjerë përtokë ose të mos pësojë goditje të forta.
- Mos u përpiqni të hapni, t'i bëni shërbime, të modifikoni ose të riparoni ndonjë përbërës të IQOS ORIGINALS DUO™, ose të zëvendësoni ndonjë prej përbërësve ose baterive.
- Përdoreni IQOS ORIGINALS DUO™ vetëm në temperatura mjedisi midis 0° dhe 40° C.

Rreziqet e baterisë

IQOS ORIGINALS DUO™ ushqehet me bateri me jone-litiumi (Li-on) të mbyllura. Në kushte normale të përdorimit, bateria është e mbyllur.

- Nëse lëngu që rrjedh nga bateria gëlltitet, kërkoni menjëherë kujdes mjekësor. Mos provokoni të vjella, mos gëlltitni ushqim dhe mos pini.
- Nëse thithet avulli i lëngut që rrjedh nga bateria, merrni ajër të pastër dhe kërkoni kujdes mjekësor.
- Nëse lëngu që rrjedh nga bateria bie në kontakt me lëkurën, lani duart dhe mos prekni sytë.
- Nëse lëngu që rrjedh nga bateria bie në kontakt me sytë, shpëlajini ata menjëherë me ujë të rrjedhshëm për të paktën 15 minuta dhe kërkoni menjëherë kujdes mjekësor.

▲ KUJDES Rrezik nga aerosoli i nxehtë

Mosrespektimi i këtyre paralajmërimeve dhe udhëzimeve të sigurisë mund të çojë në dëgjie termike:

- Ruajeni IQOS ORIGINALS DUO™ dhe fijet e duhanit në një vend të pastër, të thatë e të freskët.
- Mos e ekspozoni IQOS ORIGINALS DUO™ dhe fijet e duhanit në mjedise me lagështi të lartë ose nën rrezatimin e drejtpërdrejtë të diellit.
- Mos i përdorni fijet e duhanit të cilat janë ekspozuar ndaj nxehtësisë apo lagështisë së tepërt.

- Mos e hiqni fijen e duhanit ndërsa është në përdorim.
- Mos u përpiaqni asnjëherë që të prekni tehun e ngrohjes së IQOS ORIGINALS DUO™.
- Mos e përdorni asnjëherë mbajtësin IQOS ORIGINALS DUO™ pa kapakun e mbajtësit.

▲ KUJDES Rrezik reaksioni alergjik

- Përdorimi i IQOS ORIGINALS DUO™ dhe fijeve të duhanit mund të shkaktojë reaksion alergjik, si ënjtje të fytyrës, buzëve, gjuhës, mishrave të dhëmbëve, fytit, apo trupit, vështirësi në frymëmarrje ose gulçime.
- Ndaloni përdorimin e IQOS ORIGINALS DUO™ dhe fijeve të duhanit dhe kërkoni menjëherë kujdes mjekësor nëse keni ndonjë nga simptomat e listuara më lart, pasi ato mund të tregojnë një reaksion alergjik serioz.

PËRDORIMI EKSKLUZIV I FIJEVE TË DUHANIT

- Blijeni IQOS ORIGINALS DUO™ dhe fijet e duhanit vetëm në dyqanet lokale ose ato në internet të IQOS™ apo nga shitës të tjerë të autorizuar.
- Përdoreni IQOS ORIGINALS DUO™ vetëm me fijet e duhanit me ngrohje. Mos e përdorni asnjëherë IQOS ORIGINALS DUO™ me një cigare ose produkte të ngjashme të pamiratuara për t'u përdorur me IQOS ORIGINALS DUO™. Kjo mund të shkaktojë lëndime.
- Mos i modifikoni fijet e duhanit në asnjë lloj mënyre dhe mos u shtoni atyre asnjë substancë. Duke e bërë këtë, ekziston rreziku i lëndimit.

Raportimi i përvojave të pakëndshme

- Nëse keni ndonjë efekt shëndetësor të padëshiruar kur përdorni IQOS ORIGINALS DUO™ dhe/ose fijet e duhanit, këshillohuni me një profesionist të kujdesit shëndetësor.
- Ju mund të raportoni çdo përvojë ose incident të pakëndshëm drejtpërdrejt duke kontaktuar me qendrën lokale të thirrjeve (detajet mund t'i gjeni në broshurën e kujdesit ndaj klientit dhe garancisë). Duke raportuar përvojat ose incidentet e pakëndshme, ju mund të ndihmoni për të siguruar më shumë informacione për sigurinë e këtij produkti.
- Për më shumë informacione, ju lutemi të shkoni në www.iqos.com

TË DHËNA TEKNIKE

Mbajtësi:

IQOS 3 Modeli A1404/
IQOS ORIGINALS DUO™
Modeli A1406

Tipi i baterisë:

Bateri të rikarikueshme Li-jon

Hyrje: 5 V  1.6 A

Karikues xhepi:


IQOS 3 Model A1504/
IQOS ORIGINALS DUO™
Model A1505

Tipi i baterisë:

Bateri të rikarikueshme Li-jon

Hyrje: 5 V  2 A

Bluetooth® 4.1

Karikuesi i xhepit IQOS ORIGINALS DUO™ ka shenjën e simbolit  të ndjekur nga "SxxAxx," që tregon se karikuesi i xhepit IQOS ORIGINALS DUO™ mund të karikohet vetëm me një nga modelet e miratuara të përshtatësit IQOS ORIGINALS DUO™ të listuara më poshtë.

Përshtatësi i rrymës alternative:

Modeli: S82A40, S82A41, S82A42, S82A43, S82A45, S82A46

Hyrje: 100 V-240 V~ 50-60 Hz 0.3 A

Dalje: 5.0 V  2.0 A

Energjia në dalje: 10.0 W

Efektshmëria aktive mesatare: 79.0%

Konsumi i energjisë pa ngarkim: <0.09 W

Kabloja e USB-së e tipit C

Informacion për asgjësimin e IQOS ORIGINALS DUO™

E vlefshme për Bashkimin Europian dhe ZEE



Ky simbol në produkt ose në paketimin e tij tregon se ky produkt dhe pjesët e tij individuale (duke përfshirë bateritë) nuk duhet të asgjësohen me mbeturinat e tjera shtëpiake. Është përgjegjësia juaj të asgjësoni mbetjet e pajisjes tuaj, duke e dorëzuar atë në një pikë grumbullimi të caktuar për riciklimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Bateritë që do të hidhni mund të kthehen pa pagesë në pikën e shitjes.

Grumbullimi dhe riciklimi i klasifikuar i mbetjeve të pajisjeve tuaja (duke përfshirë bateritë) në kohën e asgjësimit do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore dhe në garantimin e një riciklimi në mënyrë të tillë që mbron shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Asgjësimi i mbetjeve të pajisjeve si mbeturina komunale të paklasifikuara (p.sh. me djegie të mbeturinave ose në landfill) mund të ketë efekte negative në mjedis dhe për shëndetin e njeriut.

UDHËZIME PËR HEQJEN E BATERISË (PËR ASGJËSIMIN DHE RICIKLIMIN)

Bateritë nuk duhet të hiqen nga konsumatori. Në fund të jetëgjatësisë së produktit, vetëm një riciklues i autorizuar mund t'i heqë bateritë në mënyrë të sigurt, sipas hapave të mëposhtëm.

Karikuesi i xhepit IQOS ORIGINALS DUO™ (A1505):

Hapi 1: Pajisja duhet të jetë plotësisht e shkarkuar para çmontimit.

Hiqni kapakun, më pas zhvidhosni vidat në të dyja anët.

Hapi 2: Shkëputni karikuesin nga këllëfi.

Hapi 3: Zhvidhoseni për të hequr kapësen.

Hapi 4: Shkëputni të gjitha pjesët FPC dhe konektorin për të hequr karikuesin PCB.

Hapi 5: Hiqeni baterinë dhe asgjësojeni sipas rregulloreve lokale.

Mbajtësi IQOS ORIGINALS DUO™ (A1406):

Hapi 1: Pajisja duhet të jetë plotësisht e shkarkuar para çmontimit. Hiqni këllëfin e përparmë nga Mbajtësi.

Hapi 2: Hiqni këllëfin e pasmë.

Hapi 3: Hiqni butonin ndezës nga Mbajtësi.

Hapi 4: Hiqni ngjitësin dhe materialin lidhës për të shkëputur baterinë nga pjesa qendrore dhe nga korniza. Pjesa qendrore duhet të pritët për t'u hapur, për shkak të ngjitësit.

Hapi 5: Hiqeni baterinë dhe asgjësojeni sipas rregulloreve lokale.

Konfirmimi i përputhshmërisë

Përmes kësaj, Philip Morris Products S.A. deklaron se IQOS ORIGINALS DUO™ është në përputhje me kërkesat thelbësore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/BE. Deklarata zyrtare e konformitetit mund të gjendet në: www.pmi.com/declarationofconformity

IQOS ORIGINALS DUO™ Model A1505 operon brenda brezit të frekuencave 2.402- 2.480 GHz me një fuqi maksimale të prodhimit RF që është nën 10.0 dBm.

Projektuar dhe prodhuar nën autoritetin e Philip Morris Products S.A., Quai Jeanrenaud 3, 2000 Neuchâtel, Zvicër.



Marka dhe logot e Bluetooth® janë marka tregtare të regjistruara në pronësi të Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i markave të tilla nga Philip Morris Products S.A. dhe bashkëpunëtorëve të tij është i licencuar.